

Fjalë e mbajtur e kryetarit H. Islami në mbledhjen komemorative të ASHAK-ut me rastin e vdekjes së akademik Besim Bokshit, 17. 08. 2014

E nderuara familje Bokshi,  
Të nderuar kolegë dhe miq,  
Zonja dhe zotërinj,

Jemi mbledhur sot këtu, në mjediset e Akademisë, për t'i bërë nderimet e fundit anëtarit të rregullt të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe ish-kryetarit të saj, dijetarit dhe personalitetit që pati një rrugë të bujshme jetësore, intelektuale, shkencore-hulumtuese dhe publike, akademik Besim Bokshit.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë bashkëshortin, prindin, gjyshin, mikun dhe kolegun tonë të dashur profesor Besim Bokshin.

Akademik Bokshi bën pjesë në lagjen e personaliteteve më të shquara në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare në Kosovë dhe jashtë saj këto 6 dhjetëvjetëshat e fundit, ku la gjurmë të pashlyeshme në jetën letrare-kulturore, kombëtare dhe intelektuale, në dijet albanologjike dhe veçanërisht në gjuhësinë shqiptare, duke u gjendur në majat e saj. Punën e tij e filloi në Gjakovën arsimdashëse dhe patriotike, ku në vitet e 50-ta e të 60-ta të shek. të kaluar ushtroi funksione të ndryshme në arsim dhe kulturë, për të arritur deri te bashkëpunëtori shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, të cilit në fillimet e tij i dha mbështetje të fuqishme profesionale, pastaj u zgjodh profesor i Universitetit të Prishtinës dhe anëtar i rregullt i Akademisë dhe nënkryetar dhe kryetar i saj. U shqua dhe në afirmimin e vlerave kombëtare e kulturore-civilizuese të shqiptarëve dhe në organizimin e institucioneve shkencore, pedagogjike e kulturore të Kosovës. E deshi shumë Gjakovën, por edhe ajo e deshi dhe e respektoi shumë, duke ia akorduar çmimin *qytetar i nderit të qytetit*.

Deri në minutën e fundit të jetës nuk pushoi të kontribuojë në fushën e shkencës së gjuhësisë dhe albanistikës në përgjithësi, duke zgjeruar opusin e tij shkencor me botime të reja. Për këtë dëshmon edhe dorëshkrimi që la të finalizuar, i cili këto ditë shkon në shtyp, gjithnjë në fushën e gjuhësisë shqiptare, por nuk pati jetë që ta priste daljen në dritë të tij. Vepra e tij shkencore në sferën e gjuhësisë do të mbetet pa dyshim burim reference për brezat e sotme dhe të nesërme. Pa akademik Bokshin nuk ka dyshim që gjuhësia dhe kultura shqiptare do të ishin më të varfra. Trashëgimia e ndritshme që la pas e bëjnë të pavdekshëm shkencëtarin dhe krijuesin, profesor Besim Bokshin.

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademikut Besim Bokshi, si dhe të gjithë miqve dhe shokëve të tij të shumtë anë e mbanë Kosovës dhe trojeve shqiptare.